World Health Organization

Raporti Global për Hepatitin 2026



Gjendja dhe përgjegjja

Hepatiti viral është nga sfidat më të rëndësishme të shëndetit publik në botë. Virusi i hepatitit B (HBV) dhe virusi i hepatitit C (HCV) vazhdojnë të shkaktojnë infeksione kronike duke shpjerë në cirrozë të mëlçisë, kancer të mëlçisë dhe më shumë se një milion vdekje të parakohshme çdo vit.

Megjithëse të dy infeksionet mund të parandalohen dhe trajtohen, HBV dhe HCV së bashku përbëjnë më shumë se 95% të vdekjeve të shkaktuara nga hepatiti viral.

Në zonat me përhapje të lartë të sëmundjes, shumica e infeksioneve kronike me HBV ndodhin tek fëmijët nën moshën 5 vjeç, qoftë përmes transmetimit nga nëna te foshnja gjatë lindjes ose përmes transmetimit horizontal gjatë fëmijërisë, nga njëri person te personi tjetër, përmes prerjeve dhe plagëve të hapura. Gjithashtu, njerëzit mund të infektohen me HBV përmes ekspozimit ndaj gjakut të infektuar, si rezultat i lëndimeve nga shpimet me gjilpërë, bërjes së tatuazheve, shpimeve në trup (piercing), kontaktit seksual si dhe përdorimit disa herë të gjilpërave ose mjeteve të mprehta të kontaminuara në institucionet shëndetësore, në komunitet ose tek personat që injektojnë droga.

Rrugët më të zakonshme të transmetimit të HCV përfshijnë: injeksionet dhe procedurat mjekësore të pasigurta, transfuzionet e gjakut që nuk kanë kaluar kontrollin e duhur si dhe përdorimin e përbashkët të gjilpërave tek personat që injektojnë droga.

Barra globale e hepatitit viral

Në vitin 2024, **287 milion njerëz** jetonin me infeksion kronik nga HBV ose HCV

3% e popullsisë globale

Njerëzit që jetojnë me infeksion kronik të HBV



70% e tyre ndodhen në Rajonin e Paqësorit Perëndimor dhe në Rajonin Afrikan të OBSh-së...

...ku rreth 5% e popullatës në Rajonin e Paqësorit Perëndimor dhe 5% e popullatës në Rajonin e Afrikës, jetojnë me infeksion kronik nga HBV

Njerëzit që jetojnë me infeksion të HCV



25% e tyre ndodhen në Rajonin e Mesdheut Lindor të OBSh-së...

...i cili është i vetmi rajon ku më shumë se 1% e popullatës është e infektuar me HCV

Tendencat në barrën globale të hepatitit viral

- Prevalenca globale e **infeksionit kronik me HBV tek fëmijët nën moshën 5 vjeç u ul nga 0,8% në vitin 2015 në 0,6% në vitin 2024.**
- Midis viteve **2015 dhe 2024, numri i personave që jetojnë me infeksion kronik nga HBV u zvogëlua me 7,4%.** Megjithatë, progresi ishte më i ngadalshëm në rajonet me barrë të lartë të sëmundjes, ku ekzistojnë sfida strukturore dhe programore.
- Midis viteve **2015 dhe 2024, numri i personave që jetojnë me infeksion nga HCV u zvogëlua me 20%,** kryesisht falë përdorimit të gjerë të trajtimeve shëruese, veçanërisht në vitin 2015, pas fillimit të trajtimit me antiviralë me veprim të drejtpërdrejtë (DAA), i cili zgjat vetëm 12 javë.

Incidenca

Në vitin 2024, pati **1.8 milion infeksione të reja me HBV dhe HCV**, përfshirë:

0.9 milion
infeksione të reja me HBV



0.9 milion
infeksione të reja me HCV

Midis viteve 2015 dhe 2024,
zvogëlimi i numrit të infeksioneve të reja ishin:

Infeksionet e reja kronike me HBV
ranë me 32%
duke treguar progres të rëndësishëm falë programeve të imunizimit dhe masave parandaluese

Infeksionet e reja me HCV
ranë vetëm me 8%
ulje shumë më e vogël se objektivi global për reduktim prej **80% deri në vitin 2030**

Vdekshmëria

Në vitin 2024, hepatiti viral B dhe C shkaktuan **1.3 milion vdekje në mbarë botën, si pasojë e cirrozës së mëlçisë dhe kancerit të mëlçisë**:

Vdekjet e lidhura me HBV



1.1 milion

Vdekjet e lidhura me HCV

240,000

Dhjetë vende përbënin **69% të vdekjeve nga HBV kronik,** ndërsa dhjetë vende përbënin **58% të vdekjeve nga HCV,** që flet për boshllëqe të mëdha në parandalim, diagnostikim dhe kujdes shëndetësor



Që nga viti 2015:

Vdekjet e lidhura me HBV u rritën me 17%, kryesisht për shkak të diagnostikimit dhe trajtimit të kufizuar **+17%**

Vdekjet e lidhura me HCV u ulën me 12%, kryesisht falë terapive antivirale efektive **-12%**

Eliminimi i hepatitit viral B

Mbulimi me vaksinim në vitin 2024:



85 vende kanë arritur tashmë objektivin për vitin 2030, duke ulur prevalencën e infeksionit kronik me HBV tek fëmijët nën moshën pesë vjeç në më pak se 0,1%

Testimi dhe trajtimi

Infeksioni me HBV

Nga **240 milion njerëz që jetonin me** infeksion HBV në vitin 2024, **vetëm 27% ishin diagnostikuar**

Më pak se 5% po merrnin trajtim



Infeksioni me HCV

Nga **68 milion njerëz të kualifikuar për trajtim të HCV-së** që nga viti 2015, **mbulimi me trajtim ishte vetëm 20%**

Deri në vitin 2024, **11 milion njerëz** të diagnostikuar me infeksion HCV vazhdonin të mbeteshin pa trajtim

Mbulimi i shërbimeve për reduktimin e dëmit mbetet shumë nën nivelet e rekomanduara:

Vetëm **35 gjilpëra dhe shiringa** shpërndahen në vit për çdo person që injekton droga

Objektivi global prej 300 deri në vitin 2030

Prioritetet për veprim në nivel global dhe rajonal

Për të arritur objektivat globale dhe rajonale për eliminimin e hepatitit viral deri në vitin 2030, ekzistojnë pesë prioritete kryesore për veprim:

- rritja e **mbulimit me trajtim për personat me infeksion kronik nga HBV,** veçanërisht në Rajonin e Afrikës dhe Rajonin e Paqësorit Perëndimor të OBSh-së;
- rritja e **mbulimit me trajtim për personat me infeksion nga HCV,** veçanërisht në Rajonin e Mesdheut Lindor të OBSh-së;
- përmirësimi i **mbulimit me dozën e lindjes të vaksinës kundër hepatitit B,** veçanërisht në Rajonin e Afrikës së OBSh-së;
- përmirësimi i mbulimit me **profilaksi antivirale** për parandalimin e transmetimit të infeksionit HBV nga nëna te fëmija veçanërisht në Rajonin e Afrikës së OBSh-së; dhe
- përmirësimi i **sigurisë së injektimeve jomjekësore,** veçanërisht përmes shërbimeve të zvogëlimit të dëmit për personat që injektojnë droga.

Progresi global drejt eliminimit të hepatitit viral si kërcënim për shëndetin publik deri në vitin 2030 nuk është në rrugën e duhur, por mbetet ende i arritshëm

Megjithëse, ekzistojnë metoda diagnostikuese dhe barna efektive, qasja në kujdes shëndetësor mbetet jashtëzakonisht e kufizuar në shumë mjedise me barrë të lartë të sëmundjes.

Sipas prirjeve aktuale, **objektivi global për zvogëlim prej 65% të vdekjeve të lidhura me hepatitin deri në vitin 2030, krahasuar me vitin 2015, nuk do të arrihet** pa zgjerim të shpejtë të testimit dhe trajtimit

Objektivi për vitin 2030 që synon **zvogëlim prej 95% të infeksioneve të reja me hepatit B, kërkon përmirësim të konsiderueshëm të mbulimit me dozën e lindjes të vaksinës kundër hepatitit B në Rajonin e Afrikës** dhe rritjen e mbulimit me profilaksi antivirale për parandalimin e transmetimit nga nëna te fëmija.

Me angazhim të vazhdueshëm politik, investime të mjaftueshme dhe qasje të barabartë në ndërhyrjet e provuara, eliminimi i hepatitit viral si kërcënim për shëndetin publik deri në vitin 2030 mbetet i arritshëm.